



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT KRYETARI

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, Tel-Fax:042 232491

Nr. 305/19 Prot

Tiranë, më 30.06.2016

V E N D I M

Nr. 89, Datë 30.06.2016

PËR

**EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË
DEGËN E DOGANËS KAKAVIJË "MBI ZBATIMIN E LEGJISLACIONIT
DOGANOR NË PROCESIN E REALIZIMIT TË TË ARDHURAVE
DOGANORE DHE VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË EKONOMIKO-
FINANCIARE."**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standarteve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi i Departamentit, në mbështetje të neneve 15, 25, 26 dhe 30 të Ligjit nr.154, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Mbi zbatimin e legjislacionit doganor në procesin e realizimit të të ardhurave doganore dhe vlerësimin e veprimtarisë ekonomiko-financiare" të ushtruar në Degën e Doganës Kakavijë, për periudhën 01.01.2014-31.12.2015.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi u konstatua nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve të mëparshme të lidhura me shpërblimin e dëmit. Kështu nuk është zbatuar pika nr.2 e rekomandimeve të lëna nga KLSH, sipas anekseve 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit të mëparshëm. Rezulton se për 304 subjektet me një detyrim të llogaritur në vlerën 46,038,680 lekë, janë nxjerrë vetëm 46 vendime administrative në vlerën 15,107,906 lekë, ose në masën 33 % të shumës së rekomanduar për shpërblim dëmi. Për mos zbatimin e plotë të rekomandimit, Autoriteti Doganor Kompetent, Dega e Doganës Kakavijë, i qëndron pretendimit se Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nuk i ka kthyer përgjigje shkresave nr.1431 prot datë 05.12.2013 dhe nr.1917 prot datë 10.10.2014, me të cilat Dega Doganore Kakavijë ka kërkuar ndihmë dhe asistencë të specializuar lidhur me verifikimin, analizimin dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna. Me shkresën nr. 1460 prot datë 12.12.2013 të Degës së Doganës Kakavijë (që lidhet me zbatimin e rekomandimeve të lëna në aneksin nr. 1), janë dërguar për verifikim pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave këto praktika doganore por nuk është marrë asnjë përgjigje nga Autoritetet Doganore Homologe, megjithëse kanë kaluar mbi dy vjet.

Gjithashtu, nuk janë zbatuar plotësisht rekomandimet e lëna në pikën 2.1, në vlerën 28,412,492 lekë e përbërë nga 369 raste sipas anekseve 7 deri 21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Detyrimet vinin si rezultat i veprimeve të kryera jo në përputhje me kërkesat e neneve 34-39, 256.2, 275.1, 287.2/f, 256.4, 261.1, 261.2 dhe 261.3 të Kodit Doganor dhe të Udhëzimit nr.25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore” si dhe veprimeve jo në përputhje me përcaktimet e kërkesave të “Protokollit të Origjinës”. Në lidhje me këtë rekomandim të realizuar në vlerën 19,469,091 lekë, janë nxjerrë Vendime Administrative në vlerën 2,468,736 lekë si rezultat i bashkëpunimit me strukturat kontrolluese të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. Konstatohet se nuk janë zbatuar plotësisht rekomandimet e lëna në vlerën 6,474,665 lekë.

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 13-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Drejtorja e Përgjithshme e Doganave të marrë masa për ndjekjen e praktikave që mundësojnë zbatimin e plotë të rekomandimeve të lëna nga KLSH, në vlerën **37,405,409 lekë** përmes verifikimeve doganore pranë Autoriteteve Doganore Homologe për praktikat doganore që lidhen me rekomandimet e lëna në anekseve nr.26 dhe 27.

Nga Auditi i Brendshëm i DPD, të analizohet përgjegjësia institucionale për zvarritjen e përgjigjeve që do të mundësonin arkëtimin në buxhet të shumave të konstatuara si shmangie të detyrimeve doganore

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Nga auditimi u konstatua se Zyra e Mbikëqyrjes së Regjimeve Doganore, gjatë viteve 2014, 2015 nuk ka marrë pjesë në asnjë rast dhe nuk ka mbikëqyrë procedurat e importimit të lëndëve të para dhe lëndëve ndihmëse, sasinë dhe cilësinë e materialeve nën Regjimin e Përpunimit Aktiv, në përputhje me autorizimet e lëshuara nga Drejtoria e

Përgjithshme e Doganave si dhe procedurat e zbatuara nga Autoriteti Doganor gjatë eksportit të produkteve të gatshme.

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 72-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Autoriteti Doganor Kompetent, Dega e Doganës Kakavijë, të marrë masat e duhura organizative, që doganierët e Zyrës së Mbikëqyrjes së Regjimeve ekonomike (kryesisht RPA), të monitorojnë nga afër procedurat doganore të importimit të lëndëve të para dhe materialeve ndihmëse si dhe të eksportit të produkteve të gatshme, duke forcuar nivelin e bashkëpunimit dhe përgjegjësiwe funksionale ndërmjet sektorëve përkatës brenda Degës Doganore Kakavijë dhe luftën ndaj evazionit doganor.

Menjëherë

3. Nga auditimi u konstatua se mungojnë ambientet e posaçme për administrimin e mostrave të identifikimit dhe kartave teknologjike të paraqitura nga subjektet që operojnë në Regjimin e Përpunimit Aktiv, veprim që bie ndesh me kërkesat e pikës 9 të Autorizimeve të lëshuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për këto regjime.

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 72-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Autoriteti Doganor Kompetent, Dega e Doganës Kakavijë, të marrë masa të menjëhershme, për krijimin e ambienteve të posaçme, për administrimin e mostrave identifikuese për produktet e gatshme si dhe të kartave teknologjike të prodhimit të depozituara nga këta subjekte përpunues. Të bashkëpunohet me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për kërkesat buxhetore që mund të sjellë një vendimarrje e tillë.

Menjëherë

4. Nga auditimi u konstatua se Zyra e Mbikëqyrjes së Regjimeve ekonomike nuk administronte Programin Vjetor të Kontrollit dhe Programin Vjetor të Inventarizimeve të miratuara nga Kryetari i Degës së Doganës, për t'i zbatuar gjatë vitit ushtrimor në ambientet e subjekteve të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, veprim që bie ndesh me kërkesat e ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë nenet 139/1, 140/1, e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, neni 7.

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 72-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Autoriteti Doganor Kompetent, Dega e Doganës Kakavijë, të marrë masa që çdo fillim viti të programojë dhe të miratojë Programet e Kontrollit dhe të inventarizojë mallrat gjendje në ambientet e subjekteve të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, që operojnë në Regjimin e Përpunimit Aktiv.

Menjëherë

5. Nga auditimi u konstatua se gjatë periudhës së zbatimit të Regjimit të Përpunimit Aktiv për prodhimin e produkteve të gatshme nga industria ushqimore, janë ushtruar kontrole

me grupe pune të posaçme, për verifikimin dhe analizimin e koeficienteve të shfrytëzimit të lëndëve të para dhe atyre ndihmëse gjatë zbatimit të proceseve teknologjike të prodhimit në përputhje me standardet e miratuara nga BE, por për shkak të procesit teknologjik të lartë që aplikohet në procesin e prodhimit të industrisë ushqimore, si dhe mungesës së një inxhinier teknolog për industrinë ushqimore në Degën e Doganës Kakavijë, konkluzionet e arritura nga grupi i auditimit nuk mund të konsiderohen të plota.

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 72-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Autoriteti Doganor Kompetent, Dega e Doganës Kakavijë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të marrin masa konkrete që për kontrollin e aktivitetit të subjektit prodhues të industrisë ushqimore të bashkëpunojnë me Agjencinë Kombëtare të Ushqimit (AKU), për verifikimin e koeficienteve të prodhimit që zbatohen në procesin e prodhimit.

Menjëherë

6. Nga auditimi u konstatua se në praktikat doganore të tranzitit në kopjet 4 dhe 5 të deklaratave doganore të tranzitit T1, nuk është konfirmuar ora e mbërritjes së mjeteve në doganën e destinacionit, e përcaktuar nga doganat nisëse. Nga ballafaqimi i organizuar me personelin doganor që administron parkimin e mjeteve, u konstatua se pretendimet e tyre ishin të pajustificuara, por njëkohësisht nuk funksiononte asnjë pajisje kompjuterike për të bërë regjistrimin online në sistemin “Asyccuda World” të orës kur mjetet tranzit mbërrijnë në doganën e destinacionit. Autoriteti doganor kompetent nuk ka vendosur regjistra të posaçëm të sekretuar, ku të regjistrohej ora e mbërritjes së mjeteve tranzit në doganën e destinacionit për vitin 2014 dhe 2015.

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 69-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Autoriteti Doganor Kompetent, Dega e Doganës Kakavijë, të marrin masa konkrete, për të zgjidhur në rrugë administrative dhe në një kohë sa më të shkurtër problemet e trajtuara sa më lartë, për të mbajtur në kontroll Regjimin e Tranzitit.

Menjëherë

7. Nga auditimi rezulton se 78 % e borxhit doganor gjendje në fund të vitit 2015 është mbështetur nga Autoriteti Gjyqësor Gjyrokastër me urdhra ekzekutimi në vlerën 299,721 mijë lekë, veprim i cili deri këtu tregon për punën e mirë që ka bërë Zyra e Borxhit Doganor, por niveli i arkëtimit të borxhit paraqitet shumë i ulët, duke treguar për punën e pamjaftueshme që kanë bërë strukturat e specializuara të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe strukturat e tjera të shtetit të ngarkuara me ligj për të mbështetur rikuperimin e borxhit doganor.

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 81-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Autoriteti Doganor Kompetent, Dega e Doganës Kakavijë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të marrin masa konkrete, për të zgjidhur

problemet që pengojnë rikuperimin e borxhit doganor në vlerën 299,721 mijë lekë, duke angazhuar të gjitha strukturat e specializuara për të zbatuar hap pas hapi kërkesat e legjislacionit doganor nëpërmjet një programi të posaçëm, për vendosjen e sekuestrove ekzekutive për të gjithë ato subjekte që rezultojnë në gjendje debitorë në vlera të mëdha.

Në vijimësi

8. *Nga auditimi i procedurave të vlerësimit doganor dhe klasifikimit tarifar të zhdoganimit të mallrave për periudhën 2014 dhe 2015 në Degën Doganore Kakavijë u konstatua se për artikuj të veçantë deklaroheshin kode tarifarë jo në përputhje me gjendjen faktike të këtyre mallrave fakt ky i dokumentuar dhe provuar gjatë procesit të auditimit. Këto veprime bien ndesh me rregullat bazë të Nomenklaturës së Harmonizuar të Mallrave në RSH. Kështu gjatë procesit të auditimit u konstatuan klasifikime të gabuara tarifore për mallrat “Letër kuzhine dhe tualeti jo më tepër se 36 cm gjerësi” deklaruar në kreun *4803* dhe “Ullinj të përgatitur dhe të ruajtur në tretësire ujore” deklaruar në kreun *0711*. Këta artikuj rezultojnë të deklaruar në kode tarifarë ku vlera doganore e mallit dhe tarifa doganore bazë rezultojnë në një nivel më të ulët se sa në gjendjen faktike të deklaruar nga subjektet deklarues të këtyre mallrave*

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 17-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Autoriteti Doganor Kompetent, Dega e Doganës Kakavijë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të marrë masa të menjëhershme për të trajtuar në profil të lartë risku, si dhe të kryejnë mostrime të detyrueshme laboratorike për rastet kur konstatohen deklarime doganore në krerët tarifarë *4803* dhe *0711* nga të gjithë subjektet deklarues jo vetëm në Degën Doganore Kakavijë por edhe në të gjitha Degët Doganore të territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, me qëllim moslejimin dhe parandalimin e mospagimit të detyrimeve doganore si rezultat i uljes së tarifës doganore dhe vlerësimit doganor të këtyre mallrave në klasifikime tarifore jo korrekte në kundërshtim me rregullat bazë të Nomenklaturës së Harmonizuar të Mallrave në RSH.

Menjëherë

9. *Nga auditimi i dokumentacionit doganor që shoqëron “Deklaratën Doganore” sipas përcaktimeve dhe shpjegimeve të Seksionit 4 të Titullit 10 të Kodit Doganor gjatë procedurave të zhdoganimit të mallrave u konstatua se në rastet e praktikave doganore të importit të klasifikuar në krerët *0102* deri *0105* të kryer nga disa subjektet tregtare nuk janë kryer kontrole dhe verifikime të mëtijshme fizike dhe dokumentare, me qëllim saktësimin e peshave të deklaruara nga këta operatorë tregtarë në cilësinë e deklaruesve të këtyre mallrave. Nuk rezultojnë të jenë ndërmarrë veprime të mëtijshme verifikuese sipas pikës 2 të nenit 71 të Kodit Doganor në rastet kur ka rezultuar parregullsi dokumentare në deklaratat e peshimit të mjeteve ndërmjet peshës së pasqyruar në librezën e mjetit bosh sipas certifikimit të kryer nga Drejtoritë Rajonale të Transporteve,*

dhe peshës boshe të të njëjtit mjet të nxjerrë në këtë Certifikatë Peshimi sipas formatit të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 66-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

a. Autoriteti Doganor Kompetent, Dega e Doganës Kakavijë, për raste të deklarimeve nga subjekte tregtarë operues në sektorin e importit të kafshëve dhe shpendëve të gjalla, të kërkojë standardizimin sipas modelit zyrtar të nxjerrë nga Drejtoritë Rajonale të Transporteve, gjithë librezat e mjeteve me qëllim eliminimin e parregullsive dokumentare gjatë procesit të peshimit të mjeteve të transportit si në momentin e daljes nga RSH ashtu dhe në momentin e hyrjes në RSH. Të ushtrohet e drejta e kontrollit bazuar në nenin 71 të Kodit Doganor gjatë procedurës së zhdoganimit të mallrave të natyrës kafshë dhe shpendë të gjalla që klasifikohen në krerët *0102*, *0103*, *0104* dhe *0105* mbi mjetet e transportit specifike që shoqërojnë këto mallra, për të gjithë subjektet deklarues në Degën Doganore Kakavijë me qëllim parandalimin dhe moslejimin shmangies së detyrimeve doganore dhe të procedohet për çdo rast në përputhje me përcaktimet e pjesës së VIII “Sanksionet” të Ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë

b. Dega Doganore Kakavijë për subjektet operues që kanë kryer transporte të mallrave që përfshihen në krerët *0102*, *0103*, *0104*, *0105* të kryejë veprime hetimore verifikuese në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave (nëpërmjet Drejtorisë së Kontrollit Pas Zhdoganimit në DPD), pranë Autoriteteve Doganore Homologe ku janë lëvruar mallrat, me qëllim kërkimin dhe verifikimin e saktë të të dhënave që lidhen me vlerën e mallit dhe peshën e këtyre mallrave të lëvruara dhe të transaktuara pranë selive të kompanive lëvruesve në cilësinë e eksportuesve të këtyre mallrave.

Menjëherë

10. *Nga auditimi u konstatua se nuk disponoheshin dosje vlere për subjekte të ndryshme, të plotësuara me të gjithë dokumentacionin e domosdoshëm e të nevojshëm, me qëllim pranimin e çmimit me transaksion, në përllogaritjen e vlerës doganore, veprime që nuk përputhen me kërkesat e neneve 34-40 të KD, udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 si edhe me të dhënat e disponueshme të miratuara nga komisioni i Ministrisë së Financave. Praktikant doganore, të realizuara nga Dega e Doganës Kakavijë, nuk janë shoqëruar me procesverbal mbi vlerësimin e indikatorëve në kundërshtim me nenet 285, 286, 287 e vijim të Kodit Doganor, udhëzimin nr. 25, datë 13.11.2007 “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit të dosjes më të dhëna të disponueshme dhe zhdoganimin e automjeteve dhe pjesëve të këmbimit të tyre”, si dhe në zbatim të Kodit Doganor nenet 34 “vlera e transaktuar” dhe 35/a “vlera e mallrave identike”,*

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 17-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Dega e Doganës Kakavijë të marrë masa që praktikat doganore, të pranuar me transaksion në përcaktimin e vlerës për qëllime doganore, të mbështeten me procesverbale vlerësimi.

Menjëherë

11. Nga auditimi u konstatua se për mallrat të cilat nuk kanë të dhëna të disponueshme, si dhe për mallrat e përdorura nuk është nxjerrë urdhrë nga Dega Doganore Kakavijë për miratimin dhe funksionimin e komisionit të vlerësimit, ku për konkluzionet e marra duhet të njoftohet menjëherë DPD, në zbatim të pikës 54-81 të VKM nr. 205, datë 13.03.1999 “Për dispozitat zbatuese të KD” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 “Për vlerën doganore”, udhëzimit nr. 6, 6/1/2 të DPD “Mbi vlerësimin doganor”.

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 17-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Autoriteti Doganor Kompetent Dega e Doganës Kakavijë të nxjerrë Urdhrin e Brendshëm për funksionimin e Komisionit të Vlerësimit doganor, për të vlerësuar mallrat për të cilat nuk kanë të dhëna të disponueshme të dërguar nga DPD, si dhe për mallrat e përdorura.

Menjëherë.

12. Nga auditimi i procedurave të zhdoganimit të mallrave rezultoi se: Autoriteti Doganor Kompetent Dega e Doganës Kakavijë, gjatë vlerësimit doganor të mallrave, ka pranuar nga operatorët ekonomik dokumentacion shoqërues fotokopje të pa noterizuar si: fatura e shitjes, CMR, deklarata eksportit, certifikata e origjinës, parking lista dhe në rast të veçantë edhe Euro I, veprime në kundërshtim me kërkesat e parashikuara nga VKM nr.205, datë 13.05.1999 “Për Dispozitat Zbatuese, të KD”, Udhëzimi nr.25, datë 30.11.2007 “Për verifikimin e Vlerës doganore”, si dhe udhëzimin e DPD nr.6, 6/1/2 mbi vlerësimin doganor.

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 17-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Autoriteti Doganor Kompetent Dega e Doganës Kakavijë, të marrë masa të plota organizative me qëllim që dokumentacioni shoqërues i pranuar në vlerësimin doganor të mallrave të administrohet me dokumente origjinale.

Menjëherë.

13. Nga auditimi u konstatua se: Artikulli “Letër në rulon lëndë e parë”, që sipas dokumentacionit shoqërues ka këto karakteristika, gjerësia “jo më tepër se 36cm”, dendësia “jo më shumë se 25g/m”, produkt letër në “gjendje përfundimtare”, ishte importuar dhe deklaruar në kreun tarifar *4803* me tarifë doganore 0%. Nga personeli përpunues doganor është ndërhurë në vlerën e mallit duke e rivlerësuar atë në vlerën 1 Euro/kg sipas kushtit FOB. Nga shqyrtimi i praktikave doganore u konstatua se ndryshe nga deklarimi i kryer, ky artikulli sipas shpjegimeve dhe notave shpjeguese të kapitullit 48, duhej të deklarohet në kreun *4818*, të Nomenklaturës së Mallrave në RSH dhe me të dhënë të disponueshme 1.7€/kg sipas Dosjes së të Dhënave të Disponueshme në Republikën e Shqipërisë.

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 17-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Autoriteti Doganor Kompetent, Dega e Doganës Kakavijë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Vlerës pranë DPD të pasqyrojë saktë përcaktimet për Krerët Tariforë *4803* dhe *4818* në dosjen e të dhënave të disponueshme, për qëllime të vlerësimit doganor sipas karakteristikave dhe shpjegimeve të përputhura me shpjegimet dhe shënimet e Nomenklaturës së Mallrave në Republikën e Shqipërisë.

Menjëherë.

14. Nga auditimi u konstatua se: Autoriteti Doganor Kakavijë për mallrat e deklaruar në kreun *9403* nga Individët, nuk ka ngritur komision vlerësimi për të provuar, që mallrat të jenë me origjinë EU dhe për të verifikuar shkallën e amortizimit. Gjithashtu konstatohet se Autoriteti Doganor Kakavijë nuk ka marrë në konsideratë faktin se mallrat e deklaruar në këto praktika doganore janë mallra personale dhe si të tilla duhet të deklaroheshin në kodin tarifor 99000000 të NM. Në shkresën nr.12970 prot DPD datë 28.05.14 paragrafi 1 ku përcaktohet qartë se “që të mundësohet deklarimi në kodin tarifor 99000000 të NM, mallrat duhet të udhëtojnë së bashku me bagazhet shoqëruese të tij”. Konstatohet se këto importe malli nuk përmbushin kushtet e nenit 134 pika 2.a “mallra që gjenden në bagazhin personal” si dhe kushtet e pikës 504, 508 dhe 509 të VKM nr.205 datë 13.03.1999 “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”. Në shkresën nr.12970 prot DPD datë 28.05.14 saktësohet në mënyrë të qartë se për rastet e importimit të mallrave të udhëtarëve të një natyre jo tregtare me mjete transporti nuk parashikohet procedurë e thjeshtuar dhe “deklarimi duhet të bëhet vetëm me deklaratë të detajuar”.

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 17-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Autoriteti Doganor Kompetent Dega e Doganës Kakavijë në zbatim të nenit 102 të KD “Shqyrtimi i Deklaratës doganore pas çlirimit të mallrave” të kryejë verifikimin dhe rivlerësimin e deklarimeve të kryera të mallrave “mobilje shtëpie” të evidentuara në aneksin nr.8, në kushtet e përmbushjes së Urdhrit nr.8554 prot DPD datë 13.05.2013 dhe shkresës nr.12970 prot DPD datë 28.05.14, shkresës nr. 779 Prot datë 16.01.2013 për “Rishikimin e disa indikatorëve shtesë në vlerësimin doganor të mallrave me origjinë nga vendet jashtë BE/NEU” dhe shpjegimeve të Sesionit I të Udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore”.

Në vijimësi.

15. Nga auditimi u konstatua se : Në deklaratimet doganore ka raste të keqklasifikimit tarifor të artikullit “Ullinj të ruajtur në shëllirë apo në tretësirë ujore”, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e neneve 33-37, 256.2, 256.4, 261.1, 261.2 të Kodit Doganor me pasojë shmangien e detyrimeve doganore nëpërmjet deklarimit të këtyre mallrave në nivele tarifore më të ulëta

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet nr. 17-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Autoriteti Doganor Kompetent Dega e Doganës Kakavijë të marrë masa:

a. Në të gjitha praktikat doganore të deklaruara në kreun *0711* për artikullin “Ullinj të ruajtur në shëllirë apo në tretësirë ujore” të procedohet me marrjen e mostrave për analizim në Laboratorin Kimik Doganor dhe përgjigja t’i bashkëlidhet praktikave doganore. Në cdo rast të njoftohet Drejtoria e Kontrollit Pas Zhdoganimit në Departamentin Operativ-Hetimor për rezultatet e mostrimit laboratorik

b. Autoriteti Doganor Kompetent, Dega e Doganës Kakavijë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të kryejë verifikime të dokumentacionit shoqërues të praktikave doganore pranë Autoriteteve Doganore Homologe Eksportuese, me qëllim përcaktimin e saktë të vlerës së transaktuar për subjekte që kanë importuar dhe importojnë mallra që përfshihen në krerët tariforë *0711*, si dhe të garantojnë në përputhje me legjislacionin doganor pjesën e borxhit që mund të lindë nga rezultatet e verifikimit doganor në përputhje me garantimin e pjesës së detyrimit doganor të munguar dhe që mund të rilindë në rast të ardhjes së përgjigjes negative nga Autoritetet Doganore Homologe Greqisë bazuar në nenin 204, 205, 206, 207, 208, 209, 210, 211, 212, 213 dhe 214 të Kodit Doganor sipas shpjegimeve të Pjesës VII kreu I “Garancia për të mbuluar një borxh doganor”.

Menjëherë.

16. Nga auditimi u konstatua se :Autoriteti Doganor Kakavijë ka kërkuar verifikimin e dokumentacionit tregtar të praktikave doganore të subjektit [REDAKTUAR] me NIPT [REDAKTUAR] pranë Autoriteteve Homologe Greke me shkresën nr.2436 prot Dega Doganore Kakavijë datë 16.02.2015 që korrespondon me praktikat doganore të përfshira në Vendimet Administrative nr nr.256 dhe nr.258 dhe të dërguara pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për verifikim pranë Autoriteteve Doganore Homologe të Greqisë. Në përfundim të konstatimeve audituese rezulton se nuk është mbajtur shuma e garancisë doganore në shumën **2,392,000 lekë** bazuar në nenin 204 “Personi që jep garancinë” nenit 205/ 206/ 207/ 208/ 209/ 210/ 211/ 212/ 213 dhe 214 të Kodit Doganor nga personeli përpunues doganor i këtyre praktikave doganore.

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet nr. 86-105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë

Autoriteti Doganor Kakavijë të kërkojë arkëtimin e menjëhershëm të vlerës së garancisë doganore në shumën prej **2,392,000 lekë** nga subjekti [REDAKTUAR] me nipt [REDAKTUAR], sipas aneksit nr.1, trajtuar në faqet 86-105 të Raportit Përfundimtar, bazuar në nenin 204 “Personi që jep garancinë” nenit 205/206/207/208/209/210/211/212/213 dhe 214 të Kodit Doganor nga deklaruesi i mallit ose përfaqësuesi i tij si dhe deklarohet ose garantohet shlyerja e gjithë detyrimeve doganore të mundshme që mund të lindin në rast të ardhjes së një përgjigjeje negative nga Autoriteti Doganor Homologe i Greqisë.

Menjëherë

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

B.1 Nisur nga gjetjet të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Dega e Doganës Kakavijë të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ato ligjore, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në shumën **89,612,733 lekë**.

1. Vlera prej **68,049,292 lekë (detajuar sipas anekseve nr.2-23)**, trajtuar në faqet 17-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga e cila shuma 22,683,097 lekë, për mosvjeljen e detyrimeve doganore që janë konstatuar gjatë procedurave të zhdoganimit të mallrave ku u verifikuan klasifikime tarifore jo korrekte dhe jo në përputhje me rregullat bazë të Nomenklaturës së Harmonizuar të Mallrave në RSH të dalë me ligjin nr. 9461 datë 21.12.2005, veprime jo në përputhje me nenet 34-37 të KD dhe përcaktimeve të Udhëzimit nr 25 datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave “*Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore*”, si dhe shpjegimeve dhe përcaktimeve të përcaktuara në kërkesat e Shtojcës (Aneksit) 4 të Protokollit të Origjinës si dhe nenit 22.4 të Udhërrëfyesit “*Mbi rregullat e Origjinës Preferenciale sipas MTL*” si dhe Udhëzimit nr.5883 prot, datë 16.05.2006 për “*Dokumentacionin e detyrueshëm për vërtetimin e origjinës preferenciale*”, si dhe shumës 45,366,195 lekë si gjoba doganore për shkak të këtyre shkeljeve.

Deri më 30.11.2016

2. Vlera prej **15,856,636 lekë (nga 15 subjekte, sipas aneksit nr.1)**, trajtuar në faqet 86-105 të Raportit Përfundimtar Auditimit duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, si dhe ato ligjore, për mos vjeljen e detyrimeve doganore dhe gjobave doganore gjatë marrjes së vendimeve administrative jo në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë, nga të cilat vlera **6,318,000 lekë** i përket vitit 2014.

Deri më 30.11.2016

3. Vlera prej **2,496,000 lekë** (nga 18 subjekte, sipas aneksit nr.24), trajtuar në faqet 71-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si *gjoba doganore për mos paraqitjen e praktikave doganore tranzite në doganën e destinacionit, brenda afatit limit të përcaktuar nga doganat nisëse*, veprime të kryera në kundërshtim me nenit 260 të Kodit Doganor, për të cilat duhet të ishte aplikuar gjoba në vlerë 30,000 lekë për çdo 5 orë vonësë.

Deri më 30.11.2016

4. Vlera prej **750,000 lekë** (nga 9 subjekte), trajtuar në faqet 68-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, për keq administrim të Regjimit të Përpunimit Aktiv për shkeljen e afateve të mbylljes së autorizimeve, për keq administrim të Regjimit të Lejimit të Përkohshëm për shkeljen e afateve të mbylljes së autorizimeve, për zbatim të nenit 96 pika 1,a dhe në mbështetje të nenit 20 dhe 85 të ligjit nr. 61 datë 24.05.2012 për “*Akcizat*”

në Republikën e Shqipërisë” jo në përputhje me kërkesat dhe kriteret e ligjore, për vitet 2014, 2015

Deri më 30.11.2016

5. Vlera prej **68,805 lekë** nga 7 doganierë për mos arkëtim të tarifës së qarkullimit të Automjeteve të Huaja në zbatim të ligjit nr. 9975, datë 27.08.2008 “Për Taksat Kombëtare” neni 11.1,ë “ dhe Shkresës së Drejtorisë të Përgjithshme të Doganave nr. 14969/1, datë 17.02.2008 (ankesi .nr.28), trajtuar më hollësisht në faqet 108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

B.2. RIKËRKIM SHPËRBLIM DËMI NGA AUDITIMET E MËPARSHME

1. Nga Dega e Doganës Kakavijë të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë procedurale dhe ligjore shpërblimi **i dëmit në shumën 30,930,774 lekë dhe 6,474,665 lekë** rekomanduar në auditimet e mëparshme dhe detajuar në anekset 26 dhe 27, për mosvjeljen e detyrimeve doganore dhe gjobave doganore që janë konstatuar gjatë procedurave të zhdoganimit të mallrave, keqklasifikime tarifore etj.

Menjëherë

C. MASA ADMINISTRATIVE

Bazuar në nenet 275.1 dhe 287.2/f të Kodit Doganor, mbështetur në faktet e vërtetuara dhe në të dhënat e grumbulluara gjatë auditimit, të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit i rekomandojmë **Degës së Doganës Kakavijë** të aplikojë penaltitet në masën nga 50,000 lekë deri në 200,000 lekë, për:

1. Për agjencinë doganore [REDAKTUAR] **me numër [REDAKTUAR]**, e cila operon pranë Degës së Doganës Kakavijë për problemet e konstatuara në përpilimin e DAV, 13 raste, në shkelje të neneve 256.1/a; 256.2; 275.1; 261.1; 261.3 dhe 287.2/f të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë.
2. Për agjencinë doganore “[REDAKTUAR]” **me numër [REDAKTUAR]** e cila operon pranë Degës së Doganës Kakavijë për problemet e konstatuara në përpilimin e DAV, 6 raste, në shkelje të neneve 256.1/a; 256.2; 275.1; 261.1; 261.3 dhe 287.2/f të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë.
3. Për agjencinë doganore [REDAKTUAR] **me numër [REDAKTUAR]**, e cila operon pranë Degës së Doganës Kakavijë për problemet e konstatuara në përpilimin e DAV, 6 raste, në shkelje të neneve 256.1/a; 256.2; 275.1 dhe 287.2/f të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë.

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr.115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin,

përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë: Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave dhe Kryetarit të Degës Doganore Kakavijë që në vlerësim të shkeljeve të mëposhtme sipas pikës 1 germa “b” dhe “c” të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013 të konsideruara nga ana jonë si shkelje shumë të rënda, të rënda, të bëjnë klasifikimin e tyre dhe të urdhërojnë fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien e masave përkatëse, sipas nenit 59.2 të ligjit nr. 152/2013:

a. Neni 58 germa “c-c”, nga “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet” deri në “largim nga shërbimi civil” për nëpunësit civil, si më poshtë:

1. Për z. I. M. me detyrë Këshilltar i Drejtorit të Përgjithshëm në cilësinë e ish Kryetarit të Degës Doganore

- për problemet e konstatuara në lidhje me vendimmarrjen jo të duhur ligjore gjatë nxjerrjes së vendimeve administrative doganore në kundërshtim me Ligjin nr. 8449 datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjin nr. 61 datë 25.08.2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”,

-për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara Rregulloren e Brendshme të Degëve Doganore, miratuar me nr.19095/2 prot., date 12.11.2012 në zbatim të Ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, VKM Nr. 205, datë 13.04.1999 “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”.

2. Për z E. Sh. me detyrë P/Zyrës së Klasifikimit/Vlerësimit/Kontrollit Fizik.

3. Për zj K. Xh. me detyrë doganier i Klasifikim/Vlerësim/Kontroll fizik;

4. Për zj A. A. me detyrë doganier i Klasifikim/Vlerësim/Kontroll fizik;

-për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara Rregulloren e Brendshme të Degëve Doganore, miratuar me nr.19095/2 prot., date 12.11.2012 në zbatim të Ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, VKM Nr. 205, datë 13.04.1999 “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, i ndryshuar konkretisht:

- për problemet e konstatuara në lidhje me praktika doganore të cilat janë trajtuar me transaksion jo në përputhje me kërkesat e neneve 33-37 të Kodit Doganor dhe kërkesave të Sesionit I të Udhëzimit 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore”, nxjerrë për këtë qëllim;

- për problemet e konstatuara në lidhje me praktika doganore me keq klasifikim artikujsh me pasojë shmangie të detyrimeve doganore, jo në përputhje me kërkesat e neneve 256.1/a; 256.2; 256.4; 261.1 dhe 261.2 të KD;

- për problemet e konstatuara në lidhje me praktika doganore trajtuar me origjinë preferenciale me nivel të taksës doganore 0% me deklaratë faturë, pasi konstatohet se “Deklarata Faturë” dhe dokumentacioni shoqërues tregtar nuk përmbush përcaktimet dhe shpjegimet e Shtojcës IV të Ligjit nr. 9590 datë 27.07.2006, “Për ratifikimin e marrëveshjes së stabilizim asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve

Evropiane dhe shteteve të tyre anëtare”, nenit 22 (Kushtet për bërjen e një deklarate faturë) pika 4 dhe 5, të Titullit V të Udhërrëfyesit, “Mbi Rregullat e Origjinës Preferenciale të përdorura në tregtinë ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të tjera sipas Marrëveshjeve të Tregtisë së Lirë. Konstatohet se “Deklaratat Faturë” për përfitimin e origjinës preferenciale të paraqitura nga subjektet nuk janë në përmbushje të Udhëzimit nr.5883 prot datë 16.05.2006 të DPD, “Dokumentacioni i detyrueshëm për vërtetimin e origjinës preferenciale”,

b. Neni 58 germa “b-c”, nga “mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj” deri në “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet” për nëpunësit civil, si më poshtë:

1. Për **z M. B.** me detyrë Hetues Doganor në cilësinë e ish P/Zyrës së Klasifikimit/Vlerësimit/Kontrollit Fizik dhe Ish Kryetar i Degës Doganore;

2. Për **zj.V. L.** me detyrë doganier i Klasifikim/Vlerësim/Kontroll fizik.

-për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara Rregulloren e Brendshme të Degëve Doganore, miratuar me nr.19095/2 prot., date 12.11.2012 në zbatim të Ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, VKM Nr. 205, datë 13.04.1999 “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, i ndryshuar konkretisht:

- për problemet e konstatuara në lidhje me praktika doganore të cilat janë trajtuar me transaksion jo në përputhje me kërkesat e neneve 33-37 të Kodit Doganor dhe kërkesave të Sesionit I të Udhëzimit 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore”, nxjerrë për këtë qëllim;

- për problemet e konstatuara në lidhje me praktika doganore me keq klasifikim artikujsh me pasojë shmangie të detyrimeve doganore, jo në përputhje me kërkesat e neneve 256.1/a; 256.2; 256.4; 261.1 dhe 261.2 të KD;

- për problemet e konstatuara në lidhje me praktika doganore trajtuar me origjinë preferenciale me nivel të taksës doganore 0% me deklarata faturë, pasi konstatohet se “Deklarata Faturë” dhe dokumentacioni shoqërues tregtar nuk përmbush përcaktimet dhe shpjegimet e Shtojcës IV të Ligjit nr. 9590 datë 27.07.2006, “Për ratifikimin e marrëveshjes së stabilizim asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve Evropiane dhe shteteve të tyre anëtare”, nenit 22 (Kushtet për bërjen e një deklarate faturë) pika 4 dhe 5, të Titullit V të Udhërrëfyesit, “Mbi Rregullat e Origjinës Preferenciale të përdorura në tregtinë ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të tjera sipas Marrëveshjeve të Tregtisë së Lirë. Konstatohet se “Deklaratat Faturë” për përfitimin e origjinës preferenciale të paraqitura nga subjektet nuk janë në përmbushje të Udhëzimit nr.5883 prot datë 16.05.2006 të DPD, “Dokumentacioni i detyrueshëm për vërtetimin e origjinës preferenciale”.

I. Për përgjegjësitë mbi të metat dhe mangësitë e konstatuara, të trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nuk rekomandohet masë pasi janë të larguar nga sistemi doganor ish-punonjësit e poshtë cituar:

1. ***I. Y.***, në cilësinë doganier i Klasifikim/Vlerësim/Kontroll fizik;
2. ***A. S.***, në cilësinë doganier i Klasifikim/Vlerësim/Kontroll fizik;
3. ***E. A.***, në cilësinë doganier i Klasifikim/Vlerësim/Kontroll fizik;
4. ***D. XH.***, në cilësinë doganier i Klasifikim/Vlerësim/Kontroll fizik;
5. ***M. D.***, në cilësinë doganier i Klasifikim/Vlerësim/Kontroll fizik;
6. ***A. Ll.***, , në cilësinë specialistes së Kontrollit Pas Zhdoganimit;
7. ***N. K.*** , në cilësinë doganier i Klasifikim/Vlerësim/Kontroll fizik;
8. ***N. S.***, në cilësinë doganier i Klasifikim/Vlerësim/Kontroll fizik;
9. ***L. Nj.***, në cilësinë ish Kryetarit të Degës Doganore

II. Nga analiza e të metave dhe mangësive të konstatuara dhe të trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për punonjësit: K. D, H. B., A. M., I .G., R. Z., A. F., A. V., A. SH., S .ZH., K. C., R. K., TH. N., Gj. C., A. P., R. SH., B. R., është menduar të mos rekomandohet masë disiplinore.

Me ndjekjen dhe zbatimin e masave të rekomanduara me këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R